

20180831468

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR GJKATA

Neni 1

Në Ligjin për gjykata ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006, 35/2008 dhe 150/10) në nenin 7 pas fjalës "shpërndahen" shtohet fjalët: "në mënyrë elektronike" dhe pika në fund të fjalisë fshihet dhe shtohen fjalët: "përmes sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhimin e lëndëve gjyqësore, në pajtim me ligjin."

Neni 2

Në nenin 12 në paragrafin (2) pas fjalës "civile" lidhëza " dhe" zëvendësohet me presje.

Neni 3

Në nenin 13 në paragrafin (4) pas fjalëve: "më e madhe" shtohet fjala "juridike".

Neni 4

Në nenin 18 në paragrafin (3) fjala "ndalon" zëvendësohet me fjalën " ndërpret".

Në paragrafin (5) pas fjalëve: "Republika e Maqedonisë", presja zëvendësohet me pikë dhe fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

"(6) Gjkata gjatë vendimmarrjes është e detyruar t'i zbatojë qëndrimet e shprehura në aktgjykimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Neni 5

Në nenin 31 paragrafi (1) në alinenë 1 fjalët: " persona të mitur" zëvendësohen me fjalën "fëmijë".

Neni 6

Në nenin 37 paragrafi (1) alineja 1 ndryshohet si vijon:

"- përcakton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore për çështjet me rëndësi për sigurimin e unitetit me zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej 3 muajsh, por jo më gjatë se 6 muaj, me iniciativë personale apo me iniciativë të kryetarit të gjykatës apo me iniciativë të seancave të gjykatësve apo seksioneve gjyqësore të gjykatave apo me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në faqen e internetit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë."

Alineja 10 ndryshohet si vijon:

"- kryen zgjedhjen të anëtarëve të Këshillit për vendimmarrje për ankesa kundër vendimit të marrë nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, në pajtim me ligjin,".

Në alinenë 13 fjalët: "dhe kujdeset për" zëvendësohet me fjalët: "përgjegjës është ta ndjekë të tyren".

Paragrafi (3) ndryshohet dhe vijon:

"Qëndrimet e përcaktuara parimore dhe mendimet juridike për çështjet me rëndësi për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjit nga ana e gjykatave Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë detyrimisht i publikon në ueb faqe."

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë dorëzon Raport vjetor për punën e vet, te Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë më së voni deri në fund të shkurtit të vitit rrjedhës për vitin paraprak."

Neni 7

Neni 42 ndryshohet dhe vijon:

"(1) Gjykatësit-porotë i zgjedh dhe shkarkon Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj.

(2) Për gjykatës porot mund të zgjidhet shtetas i moshës madhore i Republikës së Maqedonisë i cili ka përfunduar së paku arsimin e mesëm, i cili flet rrjedhshëm gjuhën maqedonase, gëzon prestigj për kryerjen e këtij funksioni dhe që nuk është më i vjetër se 60 vjet.

(3) Gjykatësi porot për gjykim të të miturve do të zgjidhet nga personat me përvojë në edukimin dhe arsimin e të rinjve.

(4) Pas zgjedhjes, gjykatësit porotë detyrimisht ndjekin trajnime të specializuara të organizuara nga Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë për të cilët Akademia lëshon vërtetim për trajnimin e kryer.

(5) Përmbajtja, kohëzgjatja dhe zbatimi i trajnimit nga paragrafi (4) i këtij neni përcaktohet në program trajnimi të specializuar për gjykatësit porotë nga ana e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë."

Neni 8

Në nenin 45 në paragrafin (1) në alinenë 4 fjalët: "me mesatare së paku tetë" dhe fjalët: "me mesatare së paku tetë në secilën prej dy cikleve të studimeve universitare," shlyhen.

Alineja 6 ndryshohet si vijon:

"- në mënyrë aktive të njohë një nga tri gjuhët e përdorura më shpesh të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht)."

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(2) Kushti nga paragrafi (1) alineja 7 e këtij neni është i nevojshëm për pranimin e kandidatit për gjykatës për trajnimin fillestar në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë dhe i njëjti jepet në kuadër të provimit pranues në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë."

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

Neni 9

Në nenin 46 paragrafët (1) dhe (2) fjalët: "në vitin e fundit" zëvendësohen me fjalët: "në dy vlerësime të rregullta të njëpasnjëshme".

Neni 10

Në nenin 47 paragrafi (2) fjalët: "në dy vitet e fundit" zëvendësohen me fjalët: "në dy vlerësime të rregullta të njëpasnjëshme".

Në paragrafin (4) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "e cila domosdoshmërisht përmban parametra të përcaktuara dhe korniza kohore për realizimin e qëllimeve të programit për vite kalendarike".

Neni 11

Neni 48 shlyhet.

Neni 12

Në nenin 52 paragrafi (5) ndryshohet dhe vijon:

"Gjykatësi nuk guxon ta përdorë funksionin e vet dhe prestigjin e gjykatës për realizimin e interesave të tij private."

Neni 13

Në nenin 67 paragrafi (2) fjalët: "procedurë disiplinore ose procedurë për shkarkimin e tij" zëvendësohen me fjalët: "procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë".

Neni 14

Në nenin 68 shtohet paragraf i ri (1), si vijon:

"(1) Secili ka të drejtë të paraqesë parashtrësë me shkrim te kryetari të gjykatës për sjellje të pahijshme ose sjellje të pashembullt të gjykatësit në marrëdhëniet zyrtare me palët që janë në kundërshtim me kodeksin etik dhe të marrë përgjigje për të njëjtën."

Paragrafët (1) dhe (2) bëhen paragrafë (2) dhe (3).

Neni 15

Në nenin 71 paragrafi (1) pas fjalës " Akademia" fjalët: "për trajnim" shlyhen.

Neni 16

Në nenin 74 paragrafi (3) pas fjalëve: "Me ditën e" shtohen fjalët: "plotfuqishmërinë e vendimit për".

Neni 17

Në nenin 75 paragrafi (1) alineja 1 ndryshohet si vijon:

"-nëse në dy vlerësime të rregullta të njëpasnjëshme nuk i plotëson kriteret për sukses në punë, me faj të gjykatësit, pa shkaqe të arsyeshme, për çfarë është i vlerësuar me dy vlerësime negative dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë,".

Alineja 11 ndryshon si vijon:

"-nëse miratohet aktgjykim nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të cilën është përcaktuar shkelje nga nenet 5 dhe 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut."

Neni 18

Neni 76 ndryshohet si vijon:

"(1) Shkelje disiplinore më e rëndë për të cilën ngrihet procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë të gjykatësit si bazë për shkarkim llogaritet:

- 1) anëtarësimi në parti politike (neni 52 paragrafi (5));
- 2) pamundësimi i kryejes së mbikëqyrjes mbi punën e gjykatësit nga ana e gjykatës më të lartë;
- 3) shfrytëzimi i funksionit të tij dhe prestigjit të gjykatës për realizimin e interesave të tij private;
- 4) shkelje më të rëndë të rendit dhe qetësisë publike me të cilën cenohetprestigji i gjykatës dhe prestigji i tij i përcaktuar me aktgjykim gjyqësor të plotfuqishëm;
- 5) arritja e vlerësimit të pamjaftueshëm në dy vlerësime të njëpasnjëshme nga ana e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, që konsiderohet joprofesional dhe i pandërgjegjshëm për kryerje të funksionit të gjykatësit;
- 6) kryerjen e funksionit tjetër publik, punës ose veprimtarisë e cila është e papërputhshme me kryerjen e funksionit të gjykatësit;
- 7) pranimin e dhuratave dhe përfitimeve tjera në lidhje me punën e gjykatësit;
- 8) gjatë vendimmarrjes nuk i zbaton qëndrimet e shprehura në aktgjykimet përfundimtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe
- 9) nxjerr (zbulon) informata konfidenciale të cilat i ka kuptuar duke vepruar në lëndët ose duke e ushtruar funksionin e gjykatësit.

(2) Për shkelje disiplinore nga paragrafi (1), pikat 1), 3), 4), 6), 7) , 8) dhe 9) të këtij neni, kryetari i gjykatës është i obliguar në afat prej tetë ditëve nga dita e kuptimit të shkeljes së kryer, por jo më gjatë se tre muaj nga shkelja e kryer është i detyruar ta njoftojë me shkrim Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(3) Për shkeljen disiplinore nga paragrafi (1) pika 4) të këtij neni kryetari i gjykatës ku është miratuar vendimi i plotfuqishëm është i obliguar menjëherë ta njoftojë Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe kryetarin e gjykatës ku gjykatësi e kryen funksionin e gjykatësit."

Neni 19

Neni 77 ndryshohet si vijon:

“(1) Si shkelje disiplinore për të cilën ngrihet procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit për të cilën do të shqiptohet masë disiplinore konsiderohet:

1) shkelje e rregullave të Kodeksit të etikës gjyqësore që cenon prestigjin e funksionit të gjykatësit;

2) shkaktimi i shkelje më serioze të marrëdhënieve në gjyqësor që ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e funksionit të gjykatësit;

3) mosplotësimi i detyrave të mentorit dhe aftësimin profesional të bashkëpunëtorëve;

4) shkelja e të drejtave për mungesë nga puna;

5) mosplotësimi i detyrës për trajnim të vazhdueshëm;

6) mosmbajtja e togës gjyqësore dhe

7) pa shkak të arsyeshëm nuk i konvokon seancat gjyqësore në lëndët të cilat i janë ndarë në punë ose në mënyrë tjetër e prolongon procedurën ose nuk e merr lëndën në punë për ç'arsye krijohet parashkrim i ndjekjes penale ose parashkrim i zbatimit të sanksionit penal për vepër penale.

(2) Për shkelje disiplinore nga paragrafi (1) të këtij neni, kryetari i gjykatës është i obliguar në afat prej tetë ditëve nga dita e kuptimit të shkeljes së kryer, por jo më gjatë se tre muaj nga shkelja e kryer është i detyruar ta njoftojë me shkrim Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.”.

Neni 20

Në nenin 78 paragrafi (1) pas alinesë 2 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje dhe shtohet aline e re 3, si vijon:

"-dërgim në orë shtesë të trajnimit profesional në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë për të paktën tre orë në periudhë prej tre muaj dhe".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(2) Nëse gjykatësit i është shqiptuar masë disiplinore me vendim të plotfuqishëm dërgim në trajnim profesional ose ulje e rrogës në shumë prej 15% deri në 30% të pagës mujore, gjykatësi nuk mund të zgjidhet në gjykatë më të lartë, për anëtar i Këshillit Gjyqësor ose drejtor i Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, gjatë kohëzgjatjes së masës."

Neni 21

Në nenin 79 në paragrafin (1) alineja 6 ndryshohet si vijon:

"- moszbatimi i dispozitave në lidhje me menaxhimin dhe shpërndarjen e lëndëve gjyqësore,".

Pas alinesë 6, shtohen aline e re 7, si vijon:

"- shkelje e dispozitave për ndryshimin e Orarit vjetor të gjykatësve,".

Në alinenë 9 e cila bëhet alineja 10 në fund të fjalisë, fjalët: “paragrafi (2) dhe” shlyhen.

Pas alinesë 10 shtohen dy aline të reja 11 dhe 12, si vijojnë:

"- pamundëson kryerjen e mbikëqyrjes në gjykatë në përputhje me ligjin dhe

-nuk paraqet propozim për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit në pajtim me ligjin, kurse e ka ditur ose ka qenë i detyruar ta dijë për ekzistimin e arsyeve ligjore."

Në paragrafin (3) fjalët: “alineja 3” shlyhen.

Neni 22

Në nenin 84 paragrafi (1) pas fjalëve: "pas paraprakisht" shtohen fjalët: "pozitiv".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të Rregullores së Punës së Gjykatës kryen Ministria e Drejtësisë, pa u cenuar me këtë rast mëvetësia dhe pavarësia e funksionit të gjykatësit, në pajtim me Planin e Mbikëqyrjes të miratuar nga ministri i Drejtësisë më së voni në muajin dhjetor të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm kalendarik."

Pas paragrafit (3) shtohen tre paragrafë të rinj (4), (5) dhe (6), si vijojnë:

"(4) Mbikëqyrjen nga paragrafi (3) i këtij neni e kryen komision i themeluar nga ministri i Drejtësisë i përbërë nga dy përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, juristë të diplomuar me së paku 10 vjet stazh përvojë në çështje juridike pas dhënies së provimit të jurisprudencës dhe dy informatikanë të trajnuar për funksionalitetin dhe mënyrën e punës të sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhimin të lëndëve gjyqësore.

(5) Për mbikëqyrjen e kryer, komisioni nga paragrafi (4) i këtij neni përgatit raport për gjendjen e konstatuar dhe masat e propozuara për mënjanimin e parregullsive të konstatuara. Ekzemplar i raportit do të dorëzohet deri te gjykata, te gjykata më e lartë në mënyrë të drejtpërdrejtë, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(6) Ministri i Drejtësisë mundet kur do të vlerësojë se nevojitet në komision të përfshijë edhe ekspertë të jashtëm për të kontrolluar funksionimin e sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim të lëndëve në gjykata."

Neni 23

Në nenin 86 në paragrafin (1) fjalët: " mban Listë të emrave zgjedhore gjyqësore" shlyhet.

Në paragrafin (3), pika në fund të fjalisë fshihet dhe shtohen fjalët: "dhe me to do të veprohet në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale."

Paragrafi (4) ndryshohet dhe vijon:

"Ministria e Drejtësisë është shfrytëzues i të dhënave statistikore në bazat e të dhënave të sistemeve informatike në gjyqësor."

Neni 24

Në nenin 99, paragrafi (1), fjalët: " informatika me baza të të dhënave për Sistemin informatik gjyqësor" zëvendësohen me fjalët: "teknologji informatike kompetent për menaxhimin teknik të sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim të lëndëve gjyqësore dhe bazat e të dhënave që dalin nga puna e gjykatave."

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Informatikanët gjyqësorë detyrimisht në mënyrë profesionale edukohen përmes Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë."

Paragrafi (5) bëhet paragraf (6).

Paragrafi (6) shlyhet.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".